



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr. 490 / Prot  
20

Datë 4 / 2020

**Lënda:** Disa shtesa në dokumentin me Nr.1438/4 prot , datë 12.4.2011 “ Terminologjia e përdorur dhe përcaktimet e termave në mbrojtjen nga rrezatimet sigurinë dhe sigurimin e materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”

Në mbështetje të Ligjit Nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” dhe me qëllim lehtësimin e punës së të gjithë punonjësve të ekspozuar profesionalisht, agjencive të ndryshme dhe vetë trupës rregullatore amendohet dokumenti me Nr.1438/4 prot , datë 12.4.2011 “ Terminologjia e përdorur dhe përcaktimet e termave në mbrojtjen nga rrezatimet sigurinë dhe sigurimin e materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë” dhe shtohen përcaktimet si më poshtë:

**Ekspert i kualifikuar:** është personi që ka njohuri dhe trajnim të nevojshëm për të kryer teste fizike, teknike ose radiokimike, duke mundur vlerësimin e dozave dhe dhënien e këshillave për t'u siguruar mbrojtje efektive individëve si dhe funksionim të saktë të pajisjeve mbrojtëse. Aftësia për të vepruar si ekspert i kualifikuar njihet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet. Një eksperti të kualifikuar mund ti caktohet përgjegjësia teknike për detyrat e mbrojtjes nga rrezatimi i punëmarrësve dhe publikut. (Direktiva Këshillit 96/29 / Euratom)

**Përgjegjës për Mbrojtjen nga Rrezatimi (PMR):** Është personi e emëruar nga punëdhënësi i tij për të kryer një detyrë të caktuar në mbrojtjen nga rrezatimi duke përfshirë dhe mbikëqyrjen e praktikave.

**Ekspert i Fizikës Mjekësore (EFM)** është një ekspert në fizikën e rrezatimit ose teknologjinë e rrezatimit të aplikuar ndaj ekspozimit, trajnimit dhe aftësia e të cilit për të vepruar njihet nga autoritetet kompetente; i cili, sipas rastit, vepron ose jep këshilla për dozimetrinë e pacientit, për zhvillimin dhe përdorimin me teknikat dhe pajisjet komplekse, mbi optimizimin, sigurimin e cilësisë, përfshirë kontrollin teknik, dhe për çështjet e tjera për mbrojtjen nga rrezatimi që lidhen me ekspozimin. (Direktiva e Këshillit 97/43/ Euratom).

SEKRETARI  
Rustem PAÇI

KRYETARI  
Ogerta MANASTIRLIU